

Printo

LIGJ

Nr.9963, datë 21.7.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9376, DATË 21.4.2005 "PËR SPORTIN",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin Këshillit
të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9376, datë 21.4.2005 "Për sportin", të ndryshuar, bëhen këto
shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10/1, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
"Mënyra e përdorimit të këtij fondi përcaktohet me udhëzim të përbashkët të
Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe
Sporteve".

Neni 2

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 26

1. Federatat shqiptare dhe klubet sportive, me fondet publike, të dhëna nga
pushteti qendror e vendor, financojnë trajtimin për përgatitjen sportive dhe
shpërblimin e sportistëve cilësorë dhe të trajnerëve të tyre, për arritjen e
rezultateve të larta sportive.
2. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me propozimin e
federatave sportive, u jep shpërblime të veçanta sportistëve dhe trajnerëve të
tyre, për rezultate të larta në veprimtaritë ndërkombëtare sportive.
3. Kriteret për përcaktimin e rezultateve të larta sportive, kombëtare e
ndërkombëtare, masa dhe mënyra e shpërblimit, si dhe përfitimi i trajtimit për
përgatitjen sportive përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 3

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 31

Objektet sportive privatizohen nga pronarët e truallit, kur ka të tillë, në të
kundërt, jepen me koncesion, në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006
"Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe
infrastrukturë", me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni."

Neni 4

Neni 33/1 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 37, fjalët "të ardhurat nga shitja e së drejtës radiotelevizive"
hiqen.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5841, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi